

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.113 /2025	Data: 30.05.2025	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) në lidhje me nenin 8 paragrafi 1 pika 1.2, neni 19 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,nenit 5 pika paragrafi 1.3, nenit 13, nenit 20,si dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,Vendimin Paraprak 00.Nr.185/2024 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së interesit, Vendimin 00 Nr.30/2025 të datës 31.01.2025 mbi themelimin e Komisionit Vlerësues si dhe njoftimit të datës 19.05.2025 nga Komisioni Vlerësues për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e ofertave, në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2025 mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS PALUAJTSHME TË KOMUNËS, Të parcelës Nr.1420-0 ZK Shushicë (Përmes shprehjes së Interesit)

1.Miratohet oferta e përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht parcelën Nr.1420-0 ZK Shushicë me sipërfaqe prej (277115)m² pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut evidentuar sipas certifikatës pronësore, ofertuesit "FLO ENERGY SIIPK" në periudhën kohore prej 30 (tridhjetë) vitesh.

2.Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, ruajtja dhe rritja e vlerës pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit përkatësisht investimi në sektorin e energjisë së ripërtëritshme bazuar në planin e biznesit si dhe projektin ideor të paraqitur nga ofertuesit me rastin e hapjes së thirrjes publike bazuar në ofertën e përzgjedhur si me e favorshme nga Komisioni Vlerësues si në piken (1) të këtij vendimi.

3.Interesi Ekonomik i Komunës së Istogut lidhur me dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është investimi, në sektorin e energjisë së ripërtëritshme dhe realizimi i interesit publik duke bazuar në planin e biznesit dhe projektin ideor duke pas parasysh edhe qiranë vjetore në lartësi prej 0.05/euro për m².

4.Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme (për parcelën e përzgjedhur nga komisioni vlerësues) do të përcaktohen me kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të kompanisë përfutuese (ofertuese).

5.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPI-ja dhe për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.

6.Me nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis si dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

E Rugova



00

Nr./Br. 033-86 Nr. i faq/Br. 01

Data/Datumi: 09.06.2025

ISTOG - ISTOK

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.113 /2025	Data: 30.05.2025	

Skupština opštine, u skladu sa članom 12. stav 12.2 tačka (d) i članom 14. Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 (Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008) u vezi sa članom 8. stav 1 tačka 1.2, članom 19. stav 3. Zakona br. 06/L-092 o dodjeli i razmjeni nepokretne imovine opštine (Službeni list Republike Kosovo br. 10/2019), članom 5. tačka stav 1.3, članom 13, članom 20, kao i članom 22. Uredbe (QRK) br. 09/2020 o određivanju postupka za dodjelu i razmjenu nepokretne imovine opštine, članom 83. Statuta opštine Istok 01 br. 62/2010, Preliminarnom odlukom 00. br. 185/2024 o dodjeli opštinskih nekretnina na korištenje putem izražavanja interesa, Odluka 00 br. 30/2025 od 31.01.2025. o osnivanju Komisije za procjenu i obavještenje od 19.05.2025. od strane Komisije za procjenu za sprovođenje postupaka i procjenu ponuda, na sastanku održanom 30.05.2025., donesena je sljedeća odluka:

ODLUKA

O ODOBRAVANJU PONUDE KOJU JE ODABRALA KOMISIJA ZA PROCJENU ZA DOZVOLU DUGOROČNOG KORIŠĆENJA NEPOKRETNE IMOVINE OPŠTINE, na parceli br. 1420-0 ZK Šušice (Putem izražavanja interesa)

1. Ponuda koju je odabrala komisija za procjenu za dugoročno korištenje nepokretne imovine Opštine, odnosno parcele br. 1420-0 ZK Šušice površine (277115) m², nepokretne imovine Opštine Istok, evidentirano prema vlasničkom listu, ponuđaču „FLO ENERGY SHPK“ na period od 30 (trideset) godina odobrava se.
2. Svrha korištenja nepokretne imovine Opštine, očuvanje i povećanje vrijednosti javne imovine općine i razvoj djelatnosti, odnosno ulaganje u sektor obnovljivih izvora energije na osnovu poslovnog plana i idejnog projekta koji su ponuđači podnijeli prilikom otvaranja javnog poziva na osnovu ponude koju je Komisija za evaluaciju odabrala kao najpovoljniju iz tačke (1) ove odluke.
3. Ekonomski interes Opštine Istok u vezi s davanjem nekretnina na korištenje je ulaganje u sektor obnovljivih izvora energije i ostvarivanje javnog interesa na osnovu poslovnog plana i idejnog projekta, uzimajući u obzir godišnju zakupninu od 0,05 eura po m².
4. Način i uslovi korištenja nekretnina (za parcelu koju odabere komisija za evaluaciju) bit će određeni ugovorom koji će biti zaključen i potpisan između gradonačelnika Opštine i predstavnika kompanije korisnika (ponuđača).
5. Ova odluka stupa na snagu nakon što MLGA potvrdi zakonitost, a njeno sprovođenje osiguravaju gradonačelnik općine, Direkcija za katastar nekretnina i geodeziju i Direkcija za urbano planiranje i zaštitu okoliša Opštine Istok.
6. Kopija ove odluke dostavlja se: Direkciji za katastar nekretnina i geodeziju, Direkciji za urbano planiranje i zaštitu okoliša, a jedna kopija ostaje u arhivi Skupštine.

			
II			
00	039-86	01	
Data Datum: 04.06.2025			
ISTOG - ISTOK			

Predsjedavajući Skupštine
G. Enver Rugova

E. Rugova